



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 3 mars 2014
Nr.ref.: RK 564/14

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI59/13

Parashtrues

Ibrahim Rizvanolli

**Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të
Kosovës, Rev. nr. 105/2010, të 29 nëntorit 2012**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është z. Ibrahim Rizvanolli, me vendbanim në Prishtinë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin Rev. nr. 105/2010 të Gjykatës Supreme, të 15 shkurtit 2013, i cili i është dorëzuar atij më 23 mars 2013.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, i cili pretendohet të ketë shkelur nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës.

Baza juridike

4. Kërkesa është bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), nenin 22 të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 29 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja).

Procedura në Gjykatë

5. Më 18 prill 2013, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.
6. Më 29 prill 2013, Kryetari e caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.
7. Më 18 nëntor 2013, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i paraqiti Gjykatës rekomandimin për papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

8. Në mars të vitit 1989, parashtruesi i kërkesës e bleu një dyqan dhe ai duhej t'ia paguante shitësit çmimin e blerjes në këste. Më 1 janar 1999, parashtruesi i kishte ende borxh blerësit një shumë të caktuar të parave. Shitësi e inicioi procedurën civile në Gjykatën Komunale në Pejë, pasi që parashtruesi i kërkesës i kishte injoruar disa kërkesa nga ana e shitësit për t'ia paguar borxhin e mbetur.
9. Më 28 tetor 2007, Gjykata Komunale e hodhi poshtë padinë si të paafatshme.
10. Shitësi ushtroi ankesë në Gjykatën e Qarkut në Pejë kundër vendimit të Gjykatës Komunale.
11. Më 5 shkurt 2010, Gjykata e Qarkut e ndryshoi aktgjykimin e Gjykatës Komunale dhe e urdhëroi parashtruesin e kërkesës që paditësit t'ia paguajë shumën e mbetur me kamatë si dhe shpenzimet e procedurës.
12. Pas kësaj, parashtruesi paraqiti kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme "*për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale*". Ai kërkoi nga Gjykata Supreme ta

prishë aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut, në mënyrë që aktgjykimi i Gjykatës Komunale të mbetet në fuqi.

13. Më 15 shkurt 2012, Gjykata Supreme vendosi që Gjykata e Qarkut kishte të drejtë kur gjeti se Gjykata Komunale e kishte vlerësuar gjendjen faktike në mënyrë të drejtë, por e kishte zbatuar në mënyrë të gabuar të drejtën materiale, duke mos marrë parasysh ndryshimin e nenit 371 të Ligjit për marrëdhëniet detyimore, të 25 qershorit 1993, sipas të cilit periudha për parashtrimin e kërkesave ishte zgjatur prej pesë në dhjetë vite.
14. Gjykata Supreme konstatoi se afati prej dhjetë vitesh ende nuk kishte kaluar dhe se Gjykata e Qarkut e kishte aprovuar me të drejtë ankesën e shitësit si të bazuar. Prandaj, Gjykata Supreme e konfirmoi vendimin e Gjykatës së Qarkut për ndryshimin e aktgjykimit të Gjykatës Komunale.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

15. Parashtruesi pretendon para Gjykatës Kushtetuese se edhe Gjykata e Apelit, edhe ajo e Revizionit e kanë zbatuar në mënyrë të gabuar nenin 371 të Ligjit për marrëdhëniet detyimore.
16. Parashtruesi i kërkesës përfundon se vendimet e kontestuara e shkelin nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës dhe kërkon nga Gjykata që të anulojë vendimet e kontestuara.

Pranueshmëria e kërkesës

17. Gjykata para së gjithash vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar të gjitha kushtet e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore.

18. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113. 7 të Kushtetutës, i cili përcakton:

“7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

19. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 47 dhe 48 të Ligjit.

Neni 47.2 i Ligjit për Gjykatën parasheh:

“Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48 i Ligjit për Gjykatën, gjithashtu parasheh:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë”.

20. Përveç kësaj, rregulli 36 (1) a), b), dhe c), dhe (2) a) dhe d) i Rregullores parasheh:

“(1) Gjykata mund t’i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:

- a) janë shterur të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me ligj kundër vendimit ose aktgjykimit të kundërshtuar, ose*
- b) kërkesa parashtrohet brenda katër muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv të parashtruesi, ose*
- c) kërkesa është qartazi e bazuar.*

(2) Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

- a) kërkesa nuk arsyetohet prima facie, ose*

[...]

- d) kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.*

21. Gjykata konsideron se parashtruesi ka vepruar në përputhje me afatin e paraparë prej katër (4) muajsh të llogaritur nga dita e dorëzimit të aktgjykimit të Gjykatës Supreme; ka arsyetuar kërkesën me fakte relevante dhe me referencë të qartë për shkeljet e pretenduara; shprehimisht konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme si akti konkret i autoritetit publik që është objekt shqyrtimi; në mënyrë të qartë thekson ndihmën e kërkuar; duke bashkëngjitur vendime të ndryshme dhe dokumente dhe informata tjera mbështetëse.
22. Në fakt parashtruesi ka parashtruar kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme “për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale”.
23. Gjykata Supreme përfundimisht gjeti se afati kohor prej dhjetë(10) vitesh nuk kishte kaluar dhe konfirmoi vendimin e Gjykatës së Qarkut.
24. Siç u tha më lart, parashtruesi pohon se “edhe gjykata e apelit edhe gjykata e revizionit kanë zbatuar në mënyrë të gabueshme nenin 371 të Ligjit për Procedurën Kontestimore”, dhe pretendon se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme ka shkelur të drejtat e tij kushtetuese të garantuara me nenin 31 [e Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm].
25. Gjykata Kushtetuese vëren se baza e ankesës në Gjykatën Supreme konsiston me pretendimin përkitazi me “shkeljet substanciale të dispozitave të procedurës kontestimore”, dhe “zbatimin e gabuar të së drejtës materiale”.

26. Gjykata Kushtetuese konsideron se ato pretendime i përkasin domenit të ligjshmërisë; dhe më tutje vëren se asnjë pretendim i qartë nuk ishte bërë në bazë të kushtetutshmërisë para Gjykatës Supreme.
27. Në përputhje me parimin e subsidiaritetit, parashtruesi është i obliguar që të shterojë të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj, siç parashihet me nenin 113 (7) dhe dispozitat tjera ligjore, siç ceket më lart.
28. Në fakt, qëllimi i shterimit është që, në këtë rast t'i ofrohet Gjykatës Supreme mundësia e rregullimit të shkeljeve të pretenduara të Kushtetutës. Rregulli i shterimit në mënyrë operative është i gërshetuar me karakterin subsidiar të kornizës procedurale të drejtësisë kushtetuese. (shih, *mutatis mutandis*, Selmouni kundër Francës [GC], § 74; Kudla kundër Polonisë [GC], § 152; Andrásik dhe të tjerët kundër Sllovakisë (vendim).
29. Kështu pra parimi i subsidiaritetit kërkon që parashtruesi të shterojë të gjitha mundësitë procedurale në procedurë të rregullt, në mënyrë që të parandalohet shkelja e Kushtetutës apo, nëse ka, të rregullohet shkelja e tillë e të drejtave themelore. Përndryshe, parashtruesi është përgjegjës kur rasti i tij shpallet i papranueshëm nga Gjykata Kushtetuese, kur dështon të shfrytëzojë procedurat e rregullta apo kur dështon të raportojë shkeljet e Kushtetutës në procedurë të rregullt. Ai dështim do të kuptohet si heqje dorë nga e drejta për të kundërshtuar më tej shkeljen dhe për t'u ankuar. (shih, Aktvendimin në Rastin nr. KIO7/09, Demë Kurbogaj dhe Besnik Kurbogaj, Vlerësimi i Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Pkl. Nr. 61/07 të 24 nëntorit 2008, paragrafi 18).
30. Kurdoherë që një vendim gjyqësor kontestohet në bazë të një qëndrimi juridik që është i papranueshëm nga pikëpamja e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, gjykatave të rregullta që sollën vendimin duhet t'u ofrohet mundësia për të rishqyrtuar vendimin e kontestuar. Kjo do të thotë se, çdoherë, kur pretendohet shkelja e të drejtave të njeriut, nuk është e thënë që ky pretendim të arrijë në Gjykatën Kushtetuese para se të shqyrtohet paraprakisht nga gjykatat e rregullta.
31. Në rastin konkret, parashtruesi do të duhej të ishte ankuar në mënyrë të qartë në Gjykatën Supreme kundër shkeljes së pretenduar të së drejtës së tij për gjykim të drejtë, pasi që Gjykata Supreme gjithashtu "duhet të gjykojë në bazë të Kushtetutës dhe ligjit" (neni 102 (3) i Kushtetutës).
32. Në praktikë, asgjë nuk e ndaloj parashtruesin që të ankohej para Gjykatës Supreme përkitazi me shkeljen e pretenduar të së drejtës së tij për gjykim të drejtë. Nëse Gjykata Supreme do të shqyrtonte shkeljen dhe do ta rregullonte atë, kjo do përfundonte; nëse Gjykata Supreme as nuk do ta rregullonte shkeljen, apo nuk do ta shqyrtonte atë, parashtruesi do të kishte përmbushur kërkesën për shterimin e të gjitha mjeteve, në kuptimin që Gjykatës Supreme do t'i ofrohej mundësia e rregullimit të shkeljes së pretenduar.
33. Gjykata Kushtetuese tashmë ka konsideruar se "*mos shterimi i mjeteve juridike mund të nënkuptojë situatë të ndryshme: kërkesa është e parakohshme, sepse vendimi për të njëjtën çështje është ende në pritje; kërkesa ishte parashtruar në mungesë të disa ankesave; ose ankesa parashtrohet në instancën e fundit,*

pa iu dhënë mundësia asaj gjykate të instancës së fundit që të korrigjojë shkeljen e pretenduar” (shih, Aktvendimi për papranueshmëri i 4 dhjetorit 2012, në rastin nr. KI120-11, Parashtrues Ministria e Shëndetësisë, Vlerësim kushtetues i Vendimit të Gjykatës Supreme A. Nr. 551, i 20 qershorit 2011).

34. Në fakt, kjo analizë është në përputhshmëri me jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të DREJTAT E NJERIUT (në tekstin e mëtejme Gjykata Evropiane), e cila parasheh që parashtruesit vetëm duhet shteruar mjetet vendore që i kanë në dispozicion në teori dhe në praktikë në kohën përkatëse, që do të thotë se janë të arritshme, në gjendje të sigurojnë dëmshpërblim lidhur me ankesat e tyre dhe për të ofruar mundësi të arsyeshme për sukses (Sejdović kundër Italisë [GCI, nr. 56581/00, GJEDNJ 2006-IJ §46). Duhet vlerësuar, në të gjitha rrethanat e rastit, nëse parashtruesi i kërkesës ka bërë gjithçka që me arsye pritet prej tij ose prej saj për të shteruar mjetet vendore (D.H. dhe të tjerët kundër Republikës Çeke [GCI §§1162).
35. Gjykata Kushtetuese gjithashtu ka aplikuar të njëjtin justifikim me rastin e nxjerrjes së Aktvendimit për papranueshmëri mbi bazën e mos-shterimit të mjeteve, më 4 dhjetor 2012, në rastin nr. KI120/11, Ministria e Shëndetësisë, Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës Supreme A. nr. 551 të 27 janarit 2010, në rastin nr. KI41/09, Universiteti AAB-RIINVEST L.L.C. Prishtinë, kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës; dhe më 23 mars 2010, në Vendimin e saj në rastin nr. KI73/09, Mimoza Kusari Lila kundër Komisionit Qendror Zgjedhor.
36. Në parim dhe faktikisht, parashtruesi nuk mund të ankohet drejtpërdrejt në Gjykatën Kushtetuese për shkelje të të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut. Parashtruesi është dashur së pari të ankohej në Gjykatën Supreme kundër shkeljes kushtetuese. Mungesa e ankesës në Gjykatën Supreme kundër shkeljes së pretenduar të të drejtave të tij për një gjykim të drejtë, tregon se nuk janë shteruar të gjitha mjetet e ofruara nga sistemi i rregullt ligjor.
37. Sidoqoftë, Gjykata Kushtetuese konsideron se faktet e rastit nuk lejojnë një përfundim bindës se bazat e ankesës “shkelje substanciale e dispozitave të procedurës kontestimore” dhe “zbatimi i gabuar i të drejtës materiale” të pretenduar në Gjykatën Supreme, përmbushin testin e Gjykatës Evropiane.
38. Në cilëndo mënyrë, edhe nëse parashtruesi do të kishte ngritur në mënyrë të qartë pretendimet kushtetuese para Gjykatës Supreme, Gjykata Kushtetuese edhe më tej konsideron se parashtruesi nuk e ka arsyetuar dhe mbështetur me prova shkeljen e të drejtave të tij nga ana e Gjykatës Supreme.
39. Në fakt, pretendimet e parashtruesit për shkeljen e të drejtave të tij kushtetuese nuk paraqesin ndonjë bazë të mjaftueshme *prima facie* për të parashtruar rastin në Gjykatë; pakënaqësia e parashtruesit me vendimin e Gjykatës Supreme nuk mund të jetë bazë kushtetuese për t’u ankuar në Gjykatën Kushtetuese.
40. Gjykata përkujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se vendimi i kontestuar shkelë të drejtat e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe për mbrojtje të pronës, siç garantohen me nenin 31 dhe 46 të Kushtetutës.

41. Sidoqoftë, Gjykata konsideron se parashtruesi nuk i ka qartësuar saktësisht pse dhe si të drejtat e tij kushtetuese janë shkelur me vendimet e kontestuarra, kur ka konstatuar se nuk ka kaluar afati prej dhjetë vitesh. Duket se parashtruesi thjesht nuk pajtohet me rezultatin e vendimeve të kontestuarra.
42. Në të vërtetë, nga parashtruesi i kërkesës nuk është bërë asnjë pretendim mbi bazën e kushtetutshmërisë, qoftë në mënyrë implicite, qoftë në substancë, që do të mbështeste shkeljen e pretenduar të të drejtave të tij në gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe në mbrojtje të pronës.
43. Për më tepër, Gjykata përsëri vëren se parashtruesi i kërkesës ankohet në bazë “të aplikimit të gabuar të nenit 371 të Ligjit për marrëdhënie detyrimore” dhe më tutje konstaton se vendimet e kontestuarra i shkelin të drejtat e tij kushtetuese.
44. Gjykata konsideron se ankesa e parashtruesit të kërkesës i takon fushës së ligjshmërisë, e cila, si rregull, është juridiksioni i gjykatave të rregullta. Referenca e thjeshtë për një shkelje të të drejtave të tij për gjykim të drejtë dhe mbrojtje të pronës së tij nuk përbën në vetvete një bazë kushtetuese për ankesën e tij.
45. Për më tepër, parashtruesi nuk e mbështet pretendimin *prima facie* mbi baza kushtetuese dhe nuk ka ofruar prova që tregojnë se të drejtat dhe liritë e tij, të garantuara me nenin 31 dhe 46 të Kushtetutës, janë shkelur me vendimet e Gjykatës së Qarkut dhe të Gjykatës Supreme.
46. Përveç kësaj, Gjykata Kushtetuese përkujton se, nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e ligjit (ligjshmëria), që pretendohet të jenë bërë nga Gjykata e Qarkut dhe Gjykata Supreme, përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura nga Kushtetuta (kushtetutshmëria).
47. Prandaj, Gjykata Kushtetuese nuk mund të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt, përkritazi me vendimet e nxjerra nga këto gjykata. Roli i gjykatave të rregullta është t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, Garcia Ruiz kundër Spanjës [DHM], Nr. 30544/96, paragrafi 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-1).
48. Përveç kësaj, Gjykata Kushtetuese nuk mund të konsiderojë se procedurat përkatëse në Gjykatën e Qarkut dhe në Gjykatën Supreme ishin në ndonjë mënyrë të padrejta ose arbitrare (shih *mutatis mutandis*, Shub kundër Lituanisë, Vendim i GJEDNJ-së për pranueshmërinë e kërkesës Nr. 17064/06, të 30 qershorit 2009).
49. Përkundrazi, Gjykata konsideron se procedurat, të shikuara në tërësinë e tyre, janë kryer në mënyrë të tillë sa që parashtruesi ka pasur gjykim të drejtë (shih, *mutatis mutandis*, Raport i Komisionit Evropian për të Drejta të Njeriut në rastin Edwards kundër MB, Nr. 13071/87, 10 korrik 1991).

50. Për më tepër, Gjykata konsideron se të dy vendimet, ai i Gjykatës së Qarkut dhe ai i Gjykatës Supreme janë të arsyetuara mirë dhe të justifikuara në pajtim me juridiksionin e tyre.
51. Si përmbledhje, Gjykata konkludon se kërkesa e parashtruesit, në pajtim me dispozitat e kombinuara të nenit 113 (7) të Kushtetutës, nenit 48 të Ligjit dhe të rregullit 36 (1), a), b) dhe c) dhe (2) a) dhe d) të Rregullores, është qartazi e pabazuar.
52. Prandaj, kërkesa është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në përputhje me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 dhe 48 të Ligjit, dhe me rregullin 36 (1) c) dhe rregullin 56 (2) të Rregullores së punës, më 18 nëntor 2013, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Almiro Rodrigues



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. dr. Enver Hasani